



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**  
**V E N D I M**

Nr. 138 dt.10.06.1994

**PER**  
**RRITJEN E PAGAVE TE KESHILLAVE DREJTUESE**  
**TE NDERMARRJEVE TE INDUSTRISE .**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.10.06.1994, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Seksioni i Prognozës “Për rritjen e pagave të Këshillit Drejtues të Ndërmarrjeve Lokale të Industrisë”, në zbatim të vendimit të K.Ministrave Nr.623, dt.31.12.1993, mbështetur në kopetencat që i jep këtij Këshilli ligji “Për ndërmarrjet shtetërore”, Nr.7582, dt.13.07.1992, neni.15, pika.2 dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14, pika.10

**VENDOSI**

1. Aprovimin e pagave të mëposhtëme :

**1.DEGA E DRURIT**

1.Ndërmarrja e Shërbimeve Investimeve

- Paga drejtorit aprovohet 6.000 lekë.

2.Ndërmarrja e Transportit të Brendshëm

- Paga e drejtorit aprovohet 6.000 lekë në muaj.

## 2.DEGA MEKANIKE

### 1.Ndërmarrja Prodhimeve Karbonike

- Paga e drejtorit aprovohet 6.000 lekë në muaj

### 2.Uzina Metalike “Tirana”

- Paga e drejtorit aprovohet 6.500 lekë në muaj.

## 3.DEGA ARTISTIKE ARTIZANATIT

### 1.Ndërmarrja e Prodhimeve Plastike

- Paga e drejtorit aprovohet 6.000 lekë në muaj.

2. Për anëtarët e Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes kur kanë detyrën e Kryetarit të Degës Teknike, apo Ekonomike, paga e tyre u vendos të jetë 15 përqind më e vogël se e drejtorit ndërsa për specialistët anëtarë të Këshillit drejtues, paga e tyre u vendos të jetë 20 përqind më e vogël se paga e drejtorit.
3. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.623, dt.31.12.1993, drejtorit të ndërmarrjes dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues përfitojnë rritje mbi pagë (kur plotësojnë kushtet) mbi 5 deri në 50 përqind, në të njëjtën masë do të përfitojnë punonjësit e tjerë të ndërmarrjes.
4. Këto paga sipas ligjit në fjalë do të zbatohen nga 1 Janari 1994.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**